



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLIT TË ZHVILLIMIT TË  
TERRITORIT

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Korçë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**RELACION**

*Për emërtimin e një sheshi në nder të “Selim Mustafa Mborja(Venxha)”*

Mbështetur në Ligjin Nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave” neni 3 dhe në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjes vendore”, neni 54 “Normat dhe kompetencat e këshillit komunal ose bashkiak”, Gërma II), thotë: “Vendos për emërtimin e rrugëve, të shesheve, të territoreve, të institucioneve dhe të objekteve në juridiksionin e bashkisë.” Në kuadrin e zbatimit të adresarit të bazuar në historikun dhe legjendën e vendosjes së emërtimeve të rrugëve kërkohet nga ana e Këshillit të Bashkisë **të shqyrtojë propozimin për emërtimit të sheshit që krijohet midis rrugëve Blv. “Fan Noli”, rruga “Partizani”, rruga “Avni Rustemi” duke e emërtuar “Selim Mustafa Mborja(Venxha)”** :

Zoti Selim Mustafa Mborja është dekoruar me titullin “Për Merita të Veçanta Civile” nga ana e Presidentit të Republikës më 17/09/2021. Titulli i lartë u akordua me motivacion: “Në vlerësim të veprimtarisë së tij të vyer atdhetare dhe bamirëse, duke kontribuar jo vetëm financiarisht ndaj një sërë organizatash të rëndësishme shoqërore, gazetareske dhe sportive korçare, por edhe me mirënjohje të thellë ndaj gjestit të tij tejet human të dhurimit të truallit vetiak për ndërtimin e Spitalit të Korçës”.

Selim Mborja i ka dhënë shumë qytetit të tij Korçës dhe padyshim Mborjes ku ai lindi, nga të cilat u detyrua të largohet dhe me të cilat e lidhi një dashuri dhe mall i madh i pushuar deri me ndarjen nga jeta.

Veprimtaria e Selim Mborjes ka qenë intensive dhe e shumëanëshme, në periudhën 1920-1943, në trevën e Korçës dhe më gjerë, duke u bërë një prej donatorëve dhe bamirësve më të mëdhenj të kohës. Njëkohësisht Selim Mbroja njihet si një nga sipërmarrësit e parë, por që aktivitetin e tij privat dhe ekonomik e kishte të lidhur me një ndërgjigje të lartë sociale. Ajo që e dalloi Selim Mbrojen, përveç aftësive të tij si sipërmarrës, ishte dhembshuria dhe bamirësitë ndaj të varfëve e jetimëve të qytetit, ku ai nuk kursehej financiarisht duke u ardhur në ndihmë të varfërve, të


pamundurve e të sëmurëve, si dhe në nderin e kujtimin e babait e vëllait, Selim Mborja, dhuroi tokën e tij për ndërtimin e Spitalit të Korçës.

Kjo e bën atë një filantrop të madh të kohës për trevën e Korçës. Shumë nga veprat dhe investimet e tij i kanë mbetur trashëgim Korçës. Edhe pse këti investime ishin të lidhura me interesin e tij ekonomik si sipërmarrës, bamirësia, humanizmi dhe dhembshuria e tij, për më të varfërit e jetimët, vinte nga zemra e tij bujare.

Në dritën e fakteve të reja është në nderin e institucionit të bashkisë Korçë t'a emërtojë sheshin që njihet në zhargonin e përditshëm si "Rruga e Mborjes", si Sheshi "Selim Mustafa Mborja", në mënyrë që të shprehim jo vetëm vlerësimin për figurën e tij, por edhe të respektojmë memorien historike dhe trashëgiminë shpirtërore të komunitetit të fshatit Mborje.



**Aktiviteti i Zotit Mborja është i përqëndruar në:**



Në vitin 1914 themelon shoqërinë General Elektrik.

Më 18 shtator 1925 filloi ndërtimin e centralit elektrik. Në prill të vitit 1926 plotësoi një pjesë të nevojave për energji. Elektrifikimi i plotë i Korçës u njoftua nga shtypi:

“Që pardje, me një marrëveshje të kryetarit të Bashkisë, shoqëria “Xheneral Elektrik” zuri të japë dritë për tërë qytetin e jo si më parë që jepte gjer më një pas mesnate”.

**(Gazeta Koha, 6 nëntor 1926).**

Vetëm që qyteti i Korçës të kishte dritë, shoqëria “Xheneral Eltekrik” e Selim Mborjes, shpenzoi tej parashikimeve. Gazetat shkruanin: “Shoqëria ‘Xheneral Elektrik’ për të kënaqur gjatë klientët e saj nuk mori parasysh shpenzimet e rënda që i ngarkohe, sepse populli dhe klientët dëshironin dritë”. **(Gazeta Koha, 6 nëntor 1926).**

Më vonë në vitin në vitin 1936, “Xheneral Elektrik” e Slim Mbrojes, ndërtoi në Vithkuq hidrocentralin e parë në Shqipëri.

Emri i Selim Mborjes gjendet në federatën “Vatra e Shqipërisë” me qëndër në Korçë të “Kryqi i Kuq”, të “Sport Klub Korça”, të komisioni për mbledhjen e ndihmave për ngritjen e Liceut të Korçës, pas fonsi prej 50.000 franga nga buxheti i shtetit ishte i pamjaftueshëm, të “Shoqëria Cinematro”, të “Oda Ekonomike”, të “Tenis Klub Korça”, të shoqëria “Këneta e Maliqit”, etj, etj.

Në vitin 1921-22 botoi gazetën “Jetë e re”, së bashku me Fazlli Frashërin.

Projekti i fabrikës “Birra Korça”, u hartua në vitin 1928. Ndërtimi i saj nisi në tetor të vitit 1929, mbi një sipërfaqe prej 20.000 metra katrorë me vlerë 350.000 franga ari, pronë e Selim Mbrojes. Ujin e sollën nga mali i Moravës, 8 km, larg pre fabrikës. Fabrika u pajis me makineritë më të mira të kohës. Më 1931 filloi prodhimi. Regjistrimi i shoqërisë “Birra Korça”, u bë në Odën Ekonomike të Korçës më 18 dhjetor 1933.

“Në bazë të shkresës nr.2215 datë 18.12.1933 të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, me antë të së cilës urdhërohet transkriptimi i kopjes së aktit konstitues të shoqërisë anonime “Birra Korça” në regjistrin e tregtisë conform nenit 11 të Kodit Tregtar në fuqi, vërtetohet se akti konstitues i shoqërisë anonime “Birra Korça”, i omolguar prej Gjyqit Kolegjial të Korçës (dega tregtare) me vendim nr 1, datë 8 nëntor 1933, u transkriptua në radhorin e posaçëm të Odës së Tregtisë së Korçës, me nr 1 datë 18 dhjetor 1933. Shoqëria, siç rezulton nga kontrata me datë redaktimi 1 prill 1933 dhe mbaron më datë 31 dhjetor 1956 **(Gazeta e Korçës 19 dhjetor 1933).**

Inagurimi u bë pas 6 muajve: “Të hënë, më 4 të këtij muaji, në orën 5:30 padreke, u bë inagurimi i fabrikës “Birra Korça”, të shoqërisë Umberto-Mborja. Ishte ftuar një shumicë e madhe me autoritetet në krye. Të ftuarit e shumtë vizituan më parë fabrikën, e cila ishte në punim e sipër dhe admiruan makineritë e fabrikës ku ishin shtruar pa kursim birra me mezera të zgjedhura. Birra Korça është me të vërtetë me kualitet më të mirë se shumë birra të huaja, dhe e njëjta me atë të frabrikave më të dëgjua gjermane.

Z.Umberto Uberti dhe Selim Mborja pritën urimet e singerta të të gjithëve për mbarëvajtjen e shoqërisë së tyre. Shitja e birrës së Korçës filloi që dje. Çmimi i saj u caktua prej shoqërisë 4 lekë për shishet e mëdha dhe 2 për të voglat”. (**Gazeta e Korçës, e mërkurë 6 qershor 1934**).

Është themelues dhe president i “Tenis Klub Korça” më 5 maj 1931. Pasioni dhe bamirësia që e karakterizon Selim Mborjen bën të mundur themelimin e të parit klub tenisi në Shqipëri. Ai kontribuoi jo vetëm me të ardhura financiare për mbarëvajtjen e aktivitetve, por dhuroi dhe truallin e tij për ndërtimin e impianteve sportive. “Pas dy mbledhjeve të përgjithshme që u bënë, njëra të hënën e shkuar, e tjetra të premtën mbrëma, u themelua definitivisht “Teniss Klub i Korçës”. Mbledhja e parë bisedoi dhe votoi statutin dhe mbledhja e dytë zgjodhi Këshillin e formuar nga:

Kryetar: Z.Selim Mborja

Nënkryetar: Z.Major Lissoni

Sekretar: Z.Gaqo Geço

Arkëtar: Z.Mario Astarita, drejtor i Bankës Kombëtare

Drejtor sportive: Z. Von Nechvatal

Këshilltarë: Z.Saint Genez dhe Taqi Fundo



“Shoqërisë së re që u formua për përhapjen e tenisit dhe që ka për të ndihmuar kësisoj për zhvillimin e qytetit tonë i urojmë suksese”. (**Gazeta e martë 18 maj 1931**).

Gjithashtu Selim Mborja (Venxha) ka qenë një ndër presidentët e parë të Sport Klub Skënderbeu, i cili ka dhënë donacione të mëdha financiare për zhvillimin e sportit të futbollit në Korçë.

Selim Mborja (Venxha) dhuroi truallin e tij për ngritjen e Spitalit të Korçës. “Në numrin e njëditshëm patëm shkruar se Selim Mborja dhuroi në jetimët e Jetimores nga një kostum, rroba për shpirt të të ndjerëve, atit dhe vëllait të tij, kështu edhe një arë (truall) që t’ia falë Bashkisë për një spital.

Sot po marrim vesh se Z.Selim Mborja po përpiqet për ta mbaruar me qëllim që të shkruhen emrat e të ndjerit Mustafa dhe Selim Mborja si shenjë mirësie...”(Spitali do të mbante emrin Selim dhe Mustafa Mborja) (**Gazeta “Koha”, 26 korrik 1924**).

Konceptoi: Arjola Çela

**Drejtoreshë e D.P.K.ZH.T.**

---

**Urb. Zhaneta LUBONJA**

**Drejtoreshë e Dr. së Përgjithshme Juridike  
dhe e Menaxhimit të Burimeve  
Njerëzore**

---

**Anxhela (DISHNICA) QERAMIXHI**

**KRYETARI**

---

**Sotiraq FILO**